



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Deliverty	21.09	2023	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
6185/2023			1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1063/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1063/2023 të datës 08.08.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër 0770/2023 të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 10.07.2023, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1063/2023 e datës 08.08.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi me numër 0770/23 i datës 10.07.2023 i Zëvendësueses së Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Q.P. Gjilan të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e cili sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 08.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil e cila është regjistruar me shenjën A.nr1063/2023 dhe numër protokoll:5565/2023, kundër Vendimit me numër 0770/2023 të datës 10.07.2023 Zëvendësueses së Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Q.P. Gjilan.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimi të masës disiplinore, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar, ndërsa të anulojë Vendimin me numër 0770/2023 të datës 10.07.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 11.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Shërbimi Korrektues i Kosovës . Ndërsa me datën 17.08.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova: Ankesën me numër te protokollit 5565/2023 të datës 08.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimi i lëshuar me numër 0770/2023 i datës 10.07.2023; Raporti i parashtruar nga F.S i datës 23.06.2023;Deklarata e F.H e datës 27.06.2023; Deklarata e L.H e datës 26.06.2023;Deklarata e K.L e datës 27.06.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 11.08.2023; Përgjigja në ankesë e datës 17.08.2023;Akt emërimi i datës 06.03.2013; Vërtetimi me numër 171 i datës 11.08.2023; Inicimi i procedurës disiplinore me numër 0769/23 i datës 10.07.2023;Njoftim i F.S drejtuar A.K e datës 07.06.2023; Kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore me numër 0748/23 e datës 03.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja Fetije Haziri sipas Aktit të Emërimit të datës 06.03.2023 mban pozitën e punës "Zyrtar e Burimeve Njerëzore" në Qendrën e Paraburgimit Gjilan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa ndaj të njëjtës mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë gjegjësisht Zëvendësuesja e Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme e Qendrës së Paraburgimit Gjilan me datën 10.07.2023 pas përpilimit të raportit të datës 23.06.2023 ka iniciuar procedurën disiplinore për shkak të dyshimit se ankuesja ka kryer shkelje të rregullave të punës.

Tutje, mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë përmes Vendimit me numër 0770/2023 të datës 10.07.2023 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" të paraparë me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik për shkak të shkeljeve të përcaktuar në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 dhe 4.3 të së njëjtit ligj ku përcaktohet se: "4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun;" me arsyetimin se me datën 22.06.2023 në ora 08:00 gjatë kontrollimit me skener të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankueses citoj : "... Duke hyrë në skener me beri zhurmë skeneri dhe hoqa një rreth të arit që e kam pasur në dore dhe oficeri i portës

Naser Zeqiri pa te keqe beri hajgare dhe tha qe nuk e paske arin origjinal, une ia ktheva duke bere hajgare se unë vet jam origjinale dhe nuk ndryshoj jam kjo qe jam. Papritmas mbas shpine vetëm kur e kam pare qe zyrtarja e personelit znj. Fetije Haziri me tha qe unë nuk kam jarana si ti. E kam kthyer kokën dhe i kam thënë qe e edhe këtë e kam pritur nga ti dhe asnjë fjale tjetër."

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe deklaratat e dëshmitarëve të cilat janë dhënë lidhur me rastin në fjalë dhe atë deklaratën e K.L të datës 27.06.2023 i cili ka thënë se citoj: "... dhe kam dëgjuar zonja: Florie Suiqi duke thënë se " unë jam origjinal, dhe gjitha i kam origjinale pasi që detektori i alarmoj dhe thoshte se nuk ndryshoj edhe pse njerzit jetojn me shpresa të kota"! Pastaj zonja Fetije Haziri tha "çka me bo se unë skam jarana" Në as një moment skam ndegju që zonjat në fjalë ju kanë referu me emra njëra tjetrës.", ndërsa L.H përmes deklaratës të datës 26.06.2023 ka thënë, citoj: "Kam dëgjue znj. Florije Suliqi ku ka thënë: më vie keq që njerëzit ushqehen-jetojn me shpresa të kota, më pastaj znj.

tha: unë skam jarana. Unë isha tek dera për me vazhdu jashtë pikës së kontrollit-hyrjes, shoqja Florije u revoltu dhe ka thënë me zë të lartë: a jeni dëshmitar....", kurse në deklaratën e ankueses të datës 27.06.2023 e njëjta ka thënë se citoj: "Me datë:22.06.2023 në hyrje tek porta derisa bënim kontrollën Florije Suliqi duke hyrë në daister filloi me provokime duke thënë unë çdo send e kam origjinale se edhe vetë jamë origjinale (me një ton të lart) duke më shiquar në sy mua me injoranc dhe duke qeshur me cinizëm dhe në mënyrë të pa kontrolluar vazhdoj duke thënë do do po mbajnë shpresa të kota, shpresa të kota (dy here) gjithni duke ngritur zërin edhe më lartë."

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku thuhet se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil" lidhur me nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku thuhet se: "4. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpyekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit." dhe ka ardhur në përfundim se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë nuk ka arritur të jetë bindëse në arsyetimin e bërë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 0770/23 të datës 10.07.2023, përmes të cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" të paraparë me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase nuk ka arritur të konstatoj saktë se cila është pasoja dhe dëmi i shkaktuar që ndërlidhen me veprimin apo mos veprimin e ankueses, nëse dëmi është shkaktuar nga veprimi me faj apo si pasojë e mos veprimit, sikurse nuk ka arritur të konstatojë se cila është lidhja shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, ngase në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit elementet e përgjegjësisë disiplinore duhet të kenë lidhje kumulative ndërmjet vete si tersi, kurse në rastin konkret deklarata e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë në raportin e datës 22.06.2023 ku thuhet se ankuesja i është drejtuar me fjalët citoj: "unë nuk kam jarana si ti", një citim i tillë me prapashtesën e shtuar "si ti" nuk mbështetet me deklaratat e dy dëshmitarëve K.L të datës 27.06.2023 dhe L.H të datës 26.06.2023.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të lejueshmërisë së pjesëmarrjes së udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankueses në procedurën administrative gjatë së cilës ankueses

i është shqiptuar masa disiplinore, ka analizuar dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata: 1.3. kur është vetë palë, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i palës, apo me palën është kreditor apo bashkëkreditor, debitor apo bashkëdebetor, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar apo si ekspert, apo ka marrë pjesë në procedurë si këshilltar apo avokat i palës; 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij."*, nga rrjedh se Zëvendësuesja e Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Q.P. Gjilan në cilësi të udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankueses ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur ligjore të LPPA-së ngase e njëjta ka qenë vetë palë në procedurë, respektivisht Vendimin e datës 10.07.2023 përmes të cilit ankueses i kishte shqiptuar vërejtjen e ka mbështetur mbi raportin e datës 22.06.2023 hartuar nga vetë shqiptuesja e masës disiplinore e që në rrethanat e rastit konkret meqenëse ka qenë e përfshirë në rast vihet në dyshim paanshmëria e saj, prandaj edhe sikur të mos konstatoheshin shkeljet materiale të konstatuar si ë lartë, ky fakt to të mjaftonte që akti i kontestuar në Këshill të vlerësohej si i paligjshëm për shkak të shkeljes së nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase sipas nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjtit ligj, përcaktohet që secili autoritet publik kur vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të individëve duhet të zbatohen dispozitat e të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave të ligjit material dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankueses është e bazuar, ndërsa Vendimi 0770/23 i datës 10.07.2023 përmes të cilit mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses i kishte shqiptuar të njëjtës masën disiplinore, është vendim i paligjshëm siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"*, dhe si i tillë Vendimi 0770/2023 i datës 10.07.2023 nxjerrë nga Zëvendësuesja e Udhëheqëses për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Q.P. Gjilan është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1063/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.